

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK GJIROKASTËR**

Nr. 78/3 prot

Data 27.2.2025

Lënda: Njoftim për vend të lirë

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr.15/2019, "Përnxitjen e punësimit"; të ligjit nr.15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive" *Udhzimi Nr.759, datë, 30.09.2024 "Për Mënyrën e Organizimit dhe Veprimtarisë, Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Përbërjen e Njësive të zhvillimit të Institucioneve, Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe zhvillimit të vazhduar Profesional të Personelit.* Ofruesi publik i AFP-së Qendra e Formimit Profesional Publik, Gjirokaster u njofton krijimin e vendit të lire për pozicionin:

- a) Instruktor për kursin Mobileri.-- 1 person (Gjirokastër)
- b) Instruktor për kursin Kuzhine .-- 1 person (Libohove)
- c) Instruktor për kursin Rrobaqepsi.-- 1 person (Gjirokastër)
- d) Instruktor për kursin Kujdestar Social.-- 1 person (Gjirokastër)
- e) Instruktor për kursin Berber.-- 1 person (Gjirokastër)
- f) Instruktor për kursin Instalime dhe mirembajtje kondicioneresh.-1 person (Gjirokaster)
- g) Instruktor për kursin Punime muratimi dhe suvatimi.-- 1 person (Tepelene)
- h) Instruktor për kursin Aftesi dixhitale baze.-- 1 person (Gjirokastër)
- i) Instruktor për kursin Kujdestar Femijesh .-- 1 person (Gjirokastër)
- j) Instruktor për kursin Sherbime ne Bar dhe Restorant 1 person (Gjirokastër)
- k) Instruktor për kursin Parukeri 1 person (Gjirokastër)
- l) Instruktor për kursin Saldim 1 person (Gjirokastër)
- m) Instruktor për kursin Instalim dhe Mirembajtje e Rrjetit Elektrik 1 person (Gjirokastër)
- n) Instruktor për kursin Instalime dhe Mirembajtje Hidraulike 1 person (Gjirokastër)
- o) Instruktor për kursin Pasticeri 1 person (Gjirokastër)

- | | |
|---|-------------------------|
| p) Instruktor për kursin Prodhime Brumi | 1 person (Gjirokastër) |
| q) Instruktor për kursin Parukeri | 1 person (Permet) |
| r) Instruktor për kursin Kuzhine | 1 person (Gjirokastër) |
| s) Instruktor për kursin Kuzhine | 1 person (Permet) |
| t) Instruktor për kursin Gurgdhendje per punime restauruese guri.-- | 1 person (Gjirokaster) |
| u) Instruktor për kursin Servis Motori ne Automjetet e Lehta .- | 1 person (Gjirokaster) |

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të forms së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj ti jmasa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit


Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë diplomë nga një shkollë e mesme profesionale ose kualifikim profesional pas të mesëm, në fushën/profesionin e kursit/kurseve të formimit profesional, për të cilin po aplikon;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën është kualifikuar;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në);
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm;



të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, Brenda datës 10.03.2025

DREJTOR

Mihare LAPA

